



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 11.06.2019
Dokument parlamentar

RAPORT

PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.9917, DATË 19.5.2008, “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE
DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjen e datës 10.06.2019 dhe 11.06.2019 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”*”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë Z.Elton Haxhi, Drejtori i Përgjithshëm i Pastrimit të Parave Z.Elvis Koçi dhe përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë.

Relatore e projektligjit u caktua deputetja Elona Hoxha (Gjebrea).

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Përgatitja e projektligjit është bazuar në nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të raundit të pestë Vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti *Moneyval* i Këshillit të Evropës², që është organi rajonal që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF-së. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së.

Me këtë projektligj synohet përmbushje e një pjese të rekomandimeve dhe/ose kriterëve përkatëse të rekomandimeve, me fokus ato që janë vlerësuar si të papambushura apo të përmbushura pjesërisht.

Në pasqyrim të gjetjeve të mësipërme dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe të përputhshmërisë teknike të sistemit tonë të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë përpiluar dhe amendamentet që përmban ky projektligj.

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen dhe sigurinë. Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm synohet:

- a) zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;
- b) parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe i fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre;
- c) zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave/ financim terrorizmi, si dhe dënimi e zhveshja e autorëve nga përfitimet e paligjshme.

Arritja e synimeve të mësipërme realizohet nëpërmjet përafrimit të legjisllacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task Force – FATF*), i cili përcakton standardet dhe nxit zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operationale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

- ***Diskutimi në komision***

Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë Z.Elton Haxhi theksoi rëndësinë e këtij projektligji në kuadër të masave që Qeveria Shqiptare po ndërmerr së bashku me gjithë

paketën e projektligjeve lidhur me masat që duhet të ndërmerren vendi ynë në kundër të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Gjatë fjalës së tij Z. Haxhi theksoi se ky projektligj është paraqitur në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL) të Këshillit të Evropës. Ai vjen si një paketë së bashku edhe me disa ligje të tjera të cilat gjithashtu adresojnë rekomandimet e kësaj strukture lidhur me masat që duhet të ndërmerren vendi ynë në kundër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, reduktimit të informalitetit, transparencës, adresimin e problematikave dhe mundësimin e mbrojtjes së sistemit financiar nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, forcimin e integritetit të sistemit parandalues në vend, zvogëlimin e mundësisë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit nëpërmjet politikave koherente, parandalimin e hyrjes në vendin tonë të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar etj.

Relatorja e projektligjit, Znj.Hoxha (Gjebrea) u shpreh parimisht dakort me projektligjin duke vënë edhe njëherë theksin tek rëndësia e tij dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet tij.

Anëtarët e Komisionit të Sigurisë u shprehën dakort në parim me projektligjin dhe vijuan diskutimet dhe pyetjet në çështjet që lidhen me risitë e projektligjit; sa u takon organizatave fetare u kërkua informacion nëse janë subjekt fondet që financohen këto organizata dhe se si përdoren këto fonde, sa është paraprakisht numëri i këtyre organizatave, nëse gjatë vitit 2018 dhe deri tani ka pasur raste të pastrimit të parave dhe financim të terrorizmit dhe nëse po, cilat janë masat e ndërmarra nga agjencia etj

Gjithashtu, gjatë diskutimit nën për nën anëtarët e komisionit u ndalën në çështje më konkrete në funksion të përmirësimit të këtyre dispozitave.

- ***Riformulime nën për nën***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare bazuar në çështjet e parashtruara si dhe nga diskutimi nën për nën i projektligjit, i sugjeron Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision përgjegjës, komentet dhe sugjerimet si më poshtë:

- Kudo në ligj fjalët “ministri i financave” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për financat, fjalët “ministri i punëve të jashtme” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për punët e jashtme”, fjalët “Ministri i Brendshëm” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për çështjet e brendshme”, fjalët “Ministri i Drejtësisë” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për drejtësinë.”

- Në nenin 2 të projektligjit, për teknikë legislative, sugjerojmë që ndryshimet në gërmën “gj” të referohen tek gërma “g” pa qënë nevoja që gërmën “gj” ta ndajmë në “gj/1” dhe “gj/2”.
- Në nenin 26 të projektligjit, sugjerojmë që të riformulohet në tërësi duke pasur parasysh rendin si më poshtë:
 - Fillimisht të vendosen formulimet e natyrës së përgjithshme sa i takon sanksioneve dhe pastaj ato që janë të veçanta;
 - Të rishikohet masa e marzheve përse i përket gjobave pasi krijon hapsira për abuzim;
 - Të sigurihet që aplikimi i gjobave të behet në përputhje me hollësitë që do të vendosen në vendimin e Këshillit të Ministrave;
 - Formulimi i këtij neni të parashikojë procedurën e ankimit, rregullat e ankimit në organin administrativ dhe të shmangë referencat në ligjet e tjera që janë të posaçme.

- ***Përfundim***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relator

Elona (Gjebrea) HOXHA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ